

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>DPK</u>	Nr. Prot. <u>03-03/1736/20</u>
Dep. <u>DPK</u>	Br Prot. <u>03-03/1736/20</u>
Nr. 1104	Data
Broj stranica <u>04</u>	Datum <u>25-08-2020</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	25.08.2020
REFERENC-Ë:	<i>AKK- DPKPP /03-03-1645/20</i>
PËR/ZA/TO:	z. Feim IBRAHIMI, Menaxher i Zyrës së Prokurim, Komuna Ferizajt
CC:	z. Agim ALIU, Kryetari i Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion me lidhur me Tenderin titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja zyrtare të Komunës së Ferizajt"

*I nderuari z. Ibrahim,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "**Pastrimi dhe mirëmbajtja zyrtare të Komunës së Ferizajt**", me numër të prokurimit: 656/20/4264/221, dhe me nr. të brendshëm: 656/20/98/221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "**Pastrimi dhe mirëmbajtja zyrtare të Komunës së Ferizajt**", me numër të prokurimit: 656/20/4264/221, në mënyrë që të respektohen

dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

### *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 19 gusht 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1645/20*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Pastrimi dhe mirëmbajtja zyrtare të Komunës së Ferizajt**", me numër të prokurimit: 656/20/4264/221, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajt.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, të llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar prej 10,700.00 €.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma ***E-Prokurimi*** ka vërejtur se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, autoriteti kontraktues ka kërkuara ***që distanca e autolarjes nuk duhet të jetë më larg se 7 km nga qendra e qytetit të Ferizajit***. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 7 dhe 28.

Agjencia, konsideron se me formulimin e kësaj kërkesë Autoriteti kontraktues ka bërë diskriminim territorial, dhe duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 dhe 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Në paragrafin 1 në mënyrë decisive thuhet se "Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Paragrafi 2 parasheh se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik".

Paragrafi 3 "pa e cenuar paragrafin e mësipërm, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik".

Në **paragrafin 4** parashihet se “Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik”.

Ndërsa **paragrafi 2 i nenit 28** parasheh se “Autoriteti kontraktues do t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”.

Si dhe **paragrafi 7** parasheh se “ Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, Autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent”.



Autoriteti Kontraktues në zbatim të nenit 7 të këtij Ligji, duhet të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve ekonomik të interesuar. Për më tepër Autoriteti kontraktues duhet të i’u jap mundësinë operatorëve ekonomik që janë jashtë perimetrit 7 km që të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi, qiramarrje me pikat e operatorëve ekonomik që ofrojnë shërbime që ndodhen në hapësirën e kërkuar dhe në të njëjtën kohë i mundëson autoritetit kontraktues të mos krijoj shpenzime të larta me rastin e këtyre shërbimeve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, si dhe nenin 20 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*

